

KOSOVO: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rusia ka rritur operacionet e saj hibride të ndikimit me pushtimin e Ukrainës, që synojnë minimin e unitetit dhe vendosmërisë së anëtarëve të NATO-s dhe BE-së, si dhe të shteteve të tjera me rëndësi strategjike. Evropa Juglindore (EJL) në veçanti është një nga rajonet më të cenueshme ndaj ndikimit keqdashës të huaj; historikisht ajo ka qenë **fushë betejash gjeopolitike dhe propagandistike për ndikim** ndërmjet (super)fuqive rajonale dhe globale dhe efektet e qëndrueshme të kësaj lufte ndihen edhe sot. Mbrapsja nga demokracia, deficitet e qeverisjes, erozioni i lirive civile dhe ngecja e integritimit në institucionet euroatlantike e kanë vendosur rajonin në një **gjendje pasigurie politike dhe paqartësie strategjike** që janë intensifikuar pas vitit 2014. Njëkohësisht me këtë shtetet autoritare si Rusia dhe Kina zbatojnë vazhdimisht taktika të fuqisë së butë dhe të fortë në të gjithë Evropën Juglindore për të minuar besimin në demokracinë liberale dhe për të lansuar autoritarizmin si një sistem më efektiv të qeverisjes shtetërore.

Pavarësisht dënimit të gjerë nga komuniteti ndërkombëtar, pushtimi rus i Ukrainës shërbeu gjithashtu edhe për konsolidimin, forcimin dhe përshejtimin e **përpjekjeve të saj aktive** për të ndikuar në vendimmarrjen kombëtare në vendet e EJL. Në vitet para pushtimit Kremli kishte përfituar tashmë nga mjedisi rregullator jo mjaft i rreptë në EJL për t'u përfshirë **në kapjen e shtetit nëpërmjet rrjeteve jotransparente lokale të patronazhit dhe ndikimit**. Këto rrjete, të përbëra kryesisht nga biznese të lidhura me Kremlinin, politikanë dhe faktorë të tjerë të ndikimit, vazhdojnë të lehtësojnë në mënyrë aktive përdorimin e energjetikës, financave dhe medias nga Rusia si armë për të mbrojtur interesat e saj. Ky shembull është ndjekur edhe nga Kina, e cila tërheq dhe financon të njëjtën infrastrukturë dhe rrjete për të ushtruar ndikimin e saj në rajon dhe për të përforcuar dinamikën autoritare lokale.

Kapja e medias dhe përdorimi i flukseve të paligjshme financiare të synuara (FPF) janë dy nga instrumentet më të rëndësishme që fuqitë e huaja autoritare përdorin për kapjen e shtetit në rajon. FPF dhe kapja e medias janë të lidhura në mënyrë të pandashme si me njëra-tjetrën, ashtu edhe me një rrjet në rritje të interesave keqdashëse. Moska dhe Pekini përfaqësojnë njërin prej komponentëve të këtij rrjeti, ndërsa **oligarkët** vendas rrjetin tjetër, e që këta të fundit kanë një ndi-

kim të konsiderueshëm politik në demokracitë ende të pakonsoliduara ballkanike. Ky raport paraqet një vlerësim të thellë të **metodave, fushëveprimit dhe objektivave të taktikave për kapjen e mediave dhe** për operacionet e **paligjshme financiare** në tetë vende të Ballkanit: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi. Ai gjithashtu zbulon shkallën në të cilën ky rrjet për ndërhyrjeve në mediat dhe për paratë e pista minojnë demokracinë dhe integritimin euroatlantik duke ndikuar në rezultatet e brendshme politike dhe vendimet e politikës së jashtme të vendeve të Evropës Juglindore.

Rusia dhe Kina prej kohësh përdorin **struktura të fshehta të pronësisë së korporatave** dhe FPF për të siguruar gjithçka – nga teknologjitë e reja dhe ekspertiza teknike deri te ndikimi ekonomik dhe politik në vendet me interes për ta. Më konkretisht, Kremli ka përfituar në mënyrë të përsëritur nga integrimi i tij në sistemin financiar perëndimor për të shfrytëzuar boshllëqet në sistemet e qeverisjes shtetërore nëpërmjet efekteve gërryese të korrupsionit dhe financimit të paligjshëm dhe rrjedhimisht të mbështesë interesat e tij keqdashëse brenda dhe jashtë shtetit. Pushtimi brutal i Ukrainës ka hedhur dritën e nevojshme mbi **rreziqet e shkaktuara nga kleptokracia** dhe rreziqet që Evropa po i ekspozon vetes – dhe botës – përmes qëndrimit të saj të dobët ndaj parave të jashtëligjshme.

Në nivel botëror vëllimi i flukseve të paligjshme financiare vlerësohet në 1-1.5 trilionë dollarë amerikanë në vit, që përbën përafërsisht 3-5% të GDP-së globale. Për krahasim, në Ballkan ato arrijnë në rreth 6% të GDP-së së rajonit. Vendet në rajon vazhdojnë të jenë shumë të cenueshme ndaj FJF – një tendencë e cila po ashpërsohet nga dobësia institucionale dhe kapja e shtetit. **Flukset e paligjshme financiare** inkurajojnë synimin për marrjen e përfitimeve dhe sjelljen kriminale, zvogëlojnë kapacitetin e qeverive për të mbështetur zhvillimin dhe rritjen gjithëpërfshirëse, minojnë sundimin e ligjit, shkatërrojnë funksionimin e sistemeve të drejtësisë penale dhe vënë në rrezik mjedisin e biznesit. Përveç kësaj, FPF-të shterojnë burimet publike, zvogëlojnë shtrirjen dhe cilësinë e shërbimeve publike dhe në këtë mënyrë minojnë integritetin e institucioneve shtetërore, duke dëmtuar në këtë mënyrë besimin e shoqërisë në qeveri. Ato gjithashtu ndihmojnë në krijimin dhe mirëmbajtjen

e rrjeteve të fuqishme të ndikimit që mund t'u shërbejnë si interesave keqdashëse të brendshme dhe të jashtme.

Flukset e paligjshme financiare në Evropën Juglindore janë të mundura në saje të ekosistemit të **përhapjes së gjerë të korrupsionit**, krimin të organizuar dhe anashkallimit të rregullave nga ana e ndërmarrjeve. Pjesërisht si rezultat i depërtimit masiv të FPF-ve ekonomitë e rajonit janë më pak konkurruese se ato në BE, duke vuajtur nga një bollëk ndërhyrjesh të padrejta politike dhe pronësie shtetërore, një sektor privat i pazhvilluar dhe prania e shpeshtë dhe e fshehtë e marrëveshjeve ndërqeveritare me shtete autoritare. Flukset e paligjshme financiare mundësohen gjithashtu nga kufijtë porozë shtetërorë në rajon, natyra e ndërvarur e ekonomive të tij dhe **sektori i madh joformal**. Si një urë lidhëse midis Azisë dhe Evropës Perëndimore EJL shërben tradicionalisht si një portë hyrëse për **drogën dhe migrantët**, si dhe për një gamë të gjerë **mallrash me përdorim të dyfishtë dhe të akcizës**. Rritja e ndjeshme e investimeve infrastrukturale në vitet e fundit – veçanërisht ato të nxitura nga Iniciativa e Kinës “Brez dhe Rrugë” dhe skema të tjera të udhëhequra nga shteti – i shtoi benzinë zjarrit, duke forcuar flukset ekzistuese të tregtisë së paligjshme.

Megjithatë, Kina nuk është e vetmja në qëndrimin e saj për të mbushur kontinentin me paratë e drejtuara nga shteti; afërsisht 1 trilionë dollarë amerikanë kapital rus janë investuar në të gjithë Evropën pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe një pjesë e konsiderueshme e këtyre mjeteve janë përdorur për blerjen e asetëve në sektorë strategjikë të ekonomisë si energjetika, telekomunikacionet, bankat, ndërtimi dhe logjistika. Mbasi Kremli arrin gjithnjë e më shumë të dominojë rrjetet lokale oligarkike ai është në gjendje **lirisht t'i kthejë në armë** këto rrjete që duken si oportuniste. Në prag të pushtimit të Ukrainës kompanitë ruse ishin ngulitur fort në ekonominë evropiane: në janar 2022 Rusia kontrollonte 277 miliardë euro në formën e investimeve të huaja direkte (IDH) në 27 shtetet anëtare të BE-së, që është me një të tretën më shumë se në fillimin e valës së sanksioneve të pafrytshme mbarë evropiane të vendosura ndaj Rusisë në përgjigje të aneksimit të Krimesë në vitin 2014. Përmasat e vërteta të investimeve ruse me siguri janë shumë më të larta se sa tregojnë shifrat zyrtare të bankave qendrore, **sepse të paktën 50 % e të gjitha flukseve financiare ruse drejt Evropës kalojnë përmes destinacioneve offshore** si Qiproja, Ishujt e Virgjër Britanikë, Irlanda, Luksemburgu dhe Niderlanda, ku mjetet financiare ruse fshihen pas formacioneve me pronarë nominalë, trusteve dhe investimeve portofoli përmes fondeve të investimeve të palëve të treta.

Në fund të vitit 2021 aktivet e korporatave ruse brenda Evropës arritën në pothuajse 600 miliardë euro, ndërsa bankat evropiane ende mbajnë 83 miliardë euro në formën e pasiveve ndaj kompanive dhe individëve rusë dhe vendet si Austria, Holanda, Italia dhe Franca kanë nivelet më të larta të ekspozimit ndaj tregut rus. Shumë nga transaksionet që bëjnë të mundur blerjen e asetëve strategjike në EJL kalojnë përmes këtyre qendrave financiare evropiane. Pas fillimit të pushtimit në shkallë të gjerë të Ukrainës në shkurt të vitit 2022, BE fillojë të shpallë sanksione gjithnjë më të rrepta ndaj Rusisë, ku Kremli ndërmerri veprime për **shkëputjen zyrtare të lidhjeve që mund të ndiqen ndaj armëve të tij të biznesit**, duke rritur fluksin e financimeve të paligjshme në Evropë dhe veçanërisht në EJL.

Megjithëse ndjekja e numrit dhe frekuencës së FPF-ve në çdo sektor të ekonomisë është e vështirë, **financimi i paligjshëm në sektorin mediatik dhe në sektorë të lidhur me të** mund të zbulohet përmes identifikimit të shenjave të ndryshme që tregojnë praninë e tyre. Një prej tyre është **përqendrimi i pronësisë së medias** në duart e individëve me burime të dyshimta të ardhurash, shpesh të lidhur me korrupsionin në nivelet e larta të pushtetit dhe me faktorë të huaj autoritarë. Në raste të tjera, **kontrolli editorial** ushtrohet nëpërmjet financimit shtetëror të siguruar nga elitat në pushtet, anëtarët e të cilëve janë implikuar vazhdimisht në skandale për mashtrime financiare apo korrupsion. Një dinamikë e ngjashme ekziston në lidhje me ofruesit në sektorin e telekomunikacionit, si dhe në lidhje me industrinë e botimeve dhe sektorët e tjerë kyç në EJL, të cilët mundësojnë kontrollin mbi infrastrukturën e shpërndarjes së përmbajtjes mediatike. Në fakt, presioni **për të kapur mediat** mund të ushtrohet nëpër sektorë të ndryshëm ekonomikë duke i kthyer të ardhurat nga reklamat në një armë për të ndikuar në politikën editoriale të mediave. **Anomalitë e papritura, afatshkurtra në përmbajtjen dhe politikën editoriale** të mediave me ndikim, sidomos në lidhje me projektet e infrastrukturës në përpjesëtime të gjera dhe nismat politike të udhëhequra nga shteti i huaj, janë gjithashtu një tregues potencial për përdorimin e FPF-ve për të ndikuar në media. Anomali të tilla në përmbajtjen mediatike janë të zakonshme në të gjithë rajonin dhe më së shpeshti manifestohen në media që janë në pronësi të rrjeteve oligarkike të afërta me forcat politike ose të lidhura ngushtë me rrjete të tilla. Edhe pse këto rrjete shpesh veprojnë për leverdinë e tyre personale dhe avancimin politik, interesat e tyre shpesh përputhen me ato të Moskës ose Pekinit, duke krijuar në këtë mënyrë **një ndërthurje keqdashëse të FPF-ve**.

Orientimi i FPF te mediat e cenueshme është një nga instrumentet kryesore që faktorët autoritarë të huaj dhe kanalet e tyre lokale përdorin për të lehtësuar kapjen e mediave, që nga ana tjetër i kthen mediat e prekura në platforma për përhapjen e **dezinformimit dhe propagandës**. Bile në vendet anëtare të BE-së – Bullgarinë dhe Kroacinë, ka mungesë të garancive të mjaftueshme institucionale në lidhje me zbulimin e pronarëve të vërtetë përfundimtarë dhe burimeve të financimit, si dhe mekanizma adekuat për kontroll ndërinstitucional dhe balancë për të parandaluar përqendrimin e pronësisë. Kjo dilemë është komplikuar vitet e fundit për shkak të rritjes së platformave të mediave sociale, të cilat ofrojnë një forum të hapur për shpërndarjen e dezinformimit dhe propagandës dhe njëkohësisht shkatërrojnë bazën për financimin e mediave tradicionale.

Deficitet e vazhdueshme të qeverisjes dhe korrupsioni sistematik në EJL i lejuan Rusisë të krijojë një prani tepër të madhe në peizazhin e informacionit të EJL në vitet që paraprijnë invazionet e saj në Ukrainë në 2014 dhe 2022. **Ndikimi kognitiv** i Kremlinit në rajon është i përqendruar në vija gjeografike, etnolinguistike dhe fetare dhe pasqyron gjendjen aktuale të pranisë së tij ekonomike dhe marrëdhënieve të tij diplomatike me secilin vend. Të dhënat e monitorimit të medias tregojnë se **dezinformimi pro-Kremlinit** është më i theksuar në vendet me lidhje të thella kulturore dhe historike me Rusinë—Bullgaria, Serbia dhe Mali i Zi, si dhe në enklavat serbe në rajon, si p.sh. Republika Srpska në Bosnje dhe Hercegovinë. U konstatua se peizazhet kryesore digjitale të lajmeve në më shumë se gjysmën e Evropës Juglindore (Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) përmbajnë dezinformime të përsëritura pro-Kremlinit, të shpërndara sistematikisht nga disa nga faqet e internetit më të vizituara të lajmeve në secilin prej këtyre vendeve. **Më së shumti bie në sy rasti i Serbisë**, ku katër nga pesë faqet e internetit më të vizituara të lajmeve publikojnë vazhdimisht dezinformime pro-Kremlinit. Përveç kësaj u konstatua se në vitin 2022 mediat kryesore të lajmeve në të gjitha vendet e Evropës Juglindore u janë referuar katër burimeve mediatike të kontrolluara nga shteti rus (TASS, RIA Novosti, RT dhe Sputnik) në mijëra artikuj.

Sondazhet e bëra sociale në të gjithë rajonin kanë vënë në dukje **një rënie të dukshme të mbështetjes shoqërore** për Rusinë, që përkon me fillimin e pushtimit dhe publikimin e mizorive të Kremlinit në Ukrainë. Megjithatë, politikat dhe fushatat dashakeqe editoriale të mediave kryesore pro-Kremlinit dhe ndonjëherë edhe të mediave kryesore dhe partive politike janë ru-

ajtur pavarësisht nga ky ndryshim në opinionin publik në masë. Subjektet politike me simpati ndaj Moskës, si SNS dhe SPS në Serbi, Vazrazhdane dhe BSP në Bullgari dhe SNSD në Bosnje, ruajtën pozitat e tyre parlamentare dhe fuqinë e tyre në marrjen e vendimeve në serinë e zgjedhjeve parlamentare 2022-2023 dhe te disa parti, si p.sh. Vazrazhdane madje vihet re një rritje e mbështetjes publike gjatë kësaj periudhe. Të kombinuara me rritjen e aktivitetit të mediave pro-Kremlinit ato kontribuan për rimëkëmbjen e pjesshme të simpatisë publike ndaj Rusisë pas tronditjes fillestare të shkaktuar nga invazioni. Mbështetja për Rusinë vazhdon të ndahet nga shumica në Serbi dhe në pjesët etnike serbe të vendeve të tjera të rajonit, duke mbetur më e lartë kudo në EJL sesa në Evropën Perëndimore gjatë gjithë periudhës.

Bullgaria dhe Serbia vazhdojnë të veprojnë si **qendra primare koordinuese dhe sheshe fillestare** për operationet e Kremlinit për ushtrimin e ndikimit në rajon. Politikanët dhe reporterët bullgarë veshin me rrobën e normalitetit dezinformimin pro-Kremlinit në vend si dhe në hapësirën euroatlantike, ndërsa Serbia ndihmon përhapjen e dezinformimit të Kremlinit në territorin e Ballkanit Perëndimor përmes mediave në gjuhën serbe, të bazuara si në Serbi ashtu edhe në enklavat serbe si Republika Srpska. Shifrat e trafikut të të dhënave të faqeve kryesore të internetit të lajmeve në Ballkanin Perëndimor pasqyrojnë konkurrencën informative për auditorin serb dhe kroat-folës midis mediave serbe pro-Kremlinit dhe botimeve kroate me orientim relativisht euroatlantik.

Kundërshtimi i përdorimit të FPF-ve dhe kapjes së medias si mjete për ndikimin keqdashës të huaj kërkon një **qëndrim të integruar, që përfshin tërë shoqërinë**, të bazuar në bashkëpunimin midis politikave kryesore në nivel kombëtar, sektorit privat, shoqërisë civile dhe strukturave institucionale evropiane dhe amerikane. Këto kundërmasa duhet të bazohen në futjen paralele të **mekanizmave për diagnostikim dhe zbatimin, të drejtuara në ndarjen e ekonomisë evropiane nga Rusia**, si p.sh.:

- krijimi i mekanizmave për mbledhjen e provave përmes të cilave do të mundësohet rritja e cilësisë dhe sasisë së të dhënave për FPF dhe identifikimi i institucioneve shtetërore dhe proceseve vendim-marrëse të prekura nga **korupsioni i institucionalizuar politik (kapja e shtetit)**;
- zbatimi i veprimeve të bashkërenditura transatlantike kundër parave të paligjshme dhe asetëve

të paligjshme në EJL përmes respektimit efektiv në mbarë BE-në të sanksioneve evropiane kundër Rusisë dhe hetimit paraprak të investimeve strategjike ruse dhe kineze.

- BE-ja dhe qeveritë vendore duhet të ndërmarrin veprime për të parandaluar flukset e paligjshme financiare nga juridiksionet e huaja autoritare në EJL duke mbështetur zbatimin e masave për luftë kundër pastrimit të parave dhe duke lejuar që pastrimi i parave të hetohet si një krim më vete dhe jo vetëm si krim predikat.
- Kapërcimi i dobësive institucionale në lidhje me financimin e paligjshëm, si p.sh. mungesa e akteve normative për transparencën e pronarëve të vërtetë dhe shtrëngimi i regjimit të studimit paraprak të investimeve duhet të plotësohet me një politikë të investimeve strategjike nga ana e BE-së dhe SHBA-së që synon futjen dhe stimulimin e praktikave të drejta të tregut.
- Kapërcimi i krizës me sigurinë energjetike dhe klimatike evropiane dhe përfundimi i varësisë së tepërt nga energjetika ruse vazhdon të jetë një komponent kryesor i shkëputjes strategjike të ekonomisë evropiane nga Rusia.

Kundërshtimi i kapjes së mediave në rajon kërkon veprime urgjente dhe të koordinuara për të kufizuar komponentët e tij, lidhur me pronësinë, reklamën, menaxhimin dhe veprimtarinë kognitive, për këto janë të nevojshme përpjekje në nivel kombëtar dhe ndër-kombëtar. Zbatimi i masave të mëposhtme do të përfaqësonte hapat e parë kyç në këtë drejtim:

- tejkalimi i boshllëqeve institucionale dhe deficiteve menaxheriale që ulin cilësinë e mjedisit mediatic dhe krijojnë dobësi kyçe të ndjeshme për t'u pushtuar. Kjo përfshin rritjen e transparencës për pronësinë, strukturat e biznesit dhe burimet e financimit të mediave, si dhe vendosjen e kufijve në përqendrimin e pronësisë së medias.
- krijimi i infrastrukturës së kriminalistikës digjitale, të nevojshme për të zbuluar dhe për të hetuar fushatat e dezinformimit dhe aktorët në to në pothuajse kohë reale, e cila do të siguronte një linjë të parë jetike të mbrojtjes kundër përhapjes së dezinformimit.
- Të dhënat e marra përmes hetimit dhe analizës së përmirësuar të fushatave aktuale të dezinformimit duhet të përdoren për të zhvilluar masa parandaluese që synojnë kufizimin e ndikimit të dezinformimit dhe faktorëve që nxisin kërkesën e tij, e pikërisht komunikim strategjik, programe mësimore në fushën e edukimit mediatic dhe informativ, fushata për rritjen e informimit të publikut dhe iniciativa për caktimin e standardeve.

Prania e Kremlinit në nyjat kritike të infrastrukturës mediatike në Evropën Juglindore mund të zhvendoset vetëm përmes krijimit të një rrjeti të shpërndarë në mënyrë të barabartë të **mediave të financuara me mjete publike dhe të menaxhuara në mënyrë të pavarur**, të afta të ringjallin karakterin qytetar të gazetarisë dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe për të rikthyer besimin e publikut në mediat.